

VENDIM
Nr.903, datë 10.11.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, PËR SHPENZIME KAPITALE, NDËRMJET
PROGRAMEVE BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Mbrojtje mjedisi” të shtohen fondet, përkatësisht për TVSH-në, në vlerën 9 720 500 (nëntë milionë e shtatëqind e njëzet mijë e pesëqind) lekë, dhe, për kosto lokale, në vlerën 7 579 500 (shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë.

b) Në programin “Administrimi i pyjeve” të pakësohen fondet, përkatësisht për TVSH-në, në vlerën 10 400 000 (dhjetë milionë e katërqind mijë) lekë dhe, për kosto lokale, në vlerën 6 900 000 (gjashtë milionë e nëntëqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen e Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha